



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 678 prot.

Fushë-Arrëz, më 5. 3. 2025

VENDIM

Nr. 8, datë 28. 02. 2025

PËR DHËNIE TITULLI "QYTETAR NDERI" I BASHKISË FUSHË-ARRËZ
Z. NDOC PRENDI

Bazuar në: Neni 54/m, Neni 8 pika 2, Neni 9 pika 1.1/b të Ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar; Neni 3 pika 1, Neni 15 pika 1/a, Neni 17, Neni 19 të Ligjit nr. 112/2013 "Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; Neni 3 pika 1, Neni 4, Neni 9 pika 1, të Ligjit Nr. 94/2022, "Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendorë të Nderit" si dhe në relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz dhe me propozimin e Shoqatës "Lëvizja Vendlindja Amanet",
Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz, në mbledhjen e datës 28.02.2025,

VENDOSI

T'i jepet titulli "Qytetar Nderi " i Bashkisë Fushë-Arrëz, **Z. Ndoc Prendi** me motivacionin:

"Për kontributin e çmuar dhe përkushtimin e tij në edukimin e brezave ndër vite, si dhe për mbështetjen e vazhdueshme në ndihmë të familjeve në nevojë në fshatrat e Njesisë Administrative Blerim për pesëmbëdhjetë vite të drejtimit me ndershmëri të kësaj Njësie".

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli i Bashkisë.

Ky vendim hy në fuqi bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 55 pika 6.

Vendimi u miratua nga Këshilli Bashkiak me:

11 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Zbardhur, më 5. 3. 2025.

SEKRETAR

Naze SELIMAJ

KRYETAR

Nikolin BARDHOKU

